Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr./Br. 897/20
Datë/Datum. 03.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.897/20

PANELI SHQYRTUES,i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068,dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Graniti" SH.P.K-Istog, kundër njoftimit për anulim të tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar për zyre" me nr. të prokurimit: 214-20-4100-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Policia e Kosovës", më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Graniti"SH.P.K-Istog, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me inventar për zyre" me nr. të prokurimit: 214-20-4100-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Policia e Kosovës".

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me inventar për zyre" me nr. të prokurimit: 214-20-4100-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Policia e Kosovës", ndërsa nëse edhe më tutje AK-ja ka interes për të vazhduar më këtë aktivitet të prokurimit, të njëjtin mund ta **Ritenderoj** konform dispozitave të LPP-së.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Graniti"SH.P.K-Istog, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 06.11.2020 me nr. 897/20, kundër njoftimit për anulim të tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me inventar për zyre" me nr. të prokurimit: 214-20-4100-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Policia e Kosovës", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 59, 60 dhe 62 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, dhe nenin 44.5 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 09.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 19.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

OE ankues pretendon se AK ka bere shkelje të neneve 1,6,7,59,60 62 të LPP-së dhe shkelje të nenit 45 të UOPP, me arsyetimin se AK anulimin e tenderit e ka bërë në mënyrë të kundërligjshme. Eksperti Shqyrtues e në parim i përkrah pretendimet ankimore pasi që arsyeja e anulimit tregon qarte për pa përgjegjshmërinë e Autoritetit Kontraktues qoftë në nivel të njësisë kërkuese qoftë në nivel të zyrës së prokurimit, për faktin se AK para se të hartoj dosjen e tenderit duhet të hartoj specifikimet teknike të cilat duhet të miratohen dhe aprovon në nivel të Autoritetit Kontraktues, e me pas të hartohet dosja e tenderit dhe të iniciohet procedura e prokurimit Edhe vet OE ankues e pranon se tek shume artikuj mungojnë specifikimet teknike andaj është e drejte që OE ankues kur konsideron se dosja e tenderit respektivisht specifikimet teknik janë ta pa qarta atëherë lëshime te tilla të ngritën gjate fazës se tenderimit. Tani jemi në një situatë te tillë ku në artikujt me nr. 4,9,10,11,15,16,20,21,dhe22 AK nuk ka specifikuar shume kërkesa të domosdoshme qe lidhen me artikujt siç janë dimensionet , pesha apo përshkrimi i artikujve , andaj si rezultat i lëshimeve të tilla te cilat mund te konsiderohen edhe jo të rastësishme anulimi i procedure se tenderimit nga ana e Eksperti Shqyrtues konsiderohet i domosdoshme për vet faktin se furnizim nuk mund të behet nëse nuk në kontratë nuk specifikohet kualiteti. Nëse i referohemi arsyeve të anulimit shihet qarte se tek artikulli 4 thellësia e dollapit

është parapa te jetë metër e jo milimetër, tek artikulli 9 është kërkuar pesha e vitrinës të jete 110 deri 120 kg, tek artikujt nr. 4,6,11,12,13,14 15,16 , mungojnë dimensionet, pastaj tek artikulli 21 mungojnë dimensionet e profilit te metalit etj. qe do te thotë se specifikimi teknik ka mangësi të shumta.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE të aprovohet pjesërisht e bazuar , ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK-së pasi qe specifikimet teknike janë te mangëta.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 19.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 20.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: "Graniti"SH.P.K-Istog, me datë: 21.11.2020, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka bere shkelje të neneve 1, 6, 7, 59, 60 dhe 62 të LPP-së dhe shkelje të nenit 45 të UOPP, me arsyetimin se AK anulimin e tenderit e ka bërë në mënyrë të kundërligjshme. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se arsyeja e anulimit të aktiviteti të prokurimit tregon qarte për pa përgjegjshmërinë e Autoritetit Kontraktues qoftë në nivel të njësisë kërkuese qoftë në nivel të zyrës së prokurimit, për faktin se AK para se të hartoj dosjen e tenderit duhet të hartoj specifikimet teknike të cilat duhet të miratohen dhe aprovon në nivel të Autoritetit Kontraktues, e me pas të hartohet dosja e tenderit dhe të iniciohet procedura e prokurimit edhe vet OE ankues e pranon se tek shume artikuj mungojnë specifikimet teknike andaj është e drejte që OE ankues kur konsideron se dosja e tenderit respektivisht specifikimet teknik janë ta pa qarta atëherë lëshime te tilla të ngritën gjate fazës se tenderimit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se tani jemi në një situatë te tillë ku në artikujt me nr. 4,

9,10,11,15,16,20,21,dhe 22 AK nuk ka specifikuar shume kërkesa të domosdoshme qe lidhen me artikujt siç janë dimensionet , pesha apo përshkrimi i artikujve, andaj si rezultat i lëshimeve të tilla të cilat mund të konsiderohen edhe jo të rastësishme anulimi i procedure se tenderimit konsiderohet i domosdoshme për vet faktin se furnizim nuk mund të behet nëse në kontratë nuk specifikohet kualiteti. Nëse i referohemi arsyeve të anulimit shihet qarte se tek artikulli 4 thellësia e dollapit është parapa të jetë metër e jo milimetër, tek artikulli 9 është kërkuar pesha e vitrinës të jete 110 deri 120 kg, tek artikujt nr. 4,6,11,12,13,14 15,16 , mungojnë dimensionet, pastaj tek artikulli 21 mungojnë dimensionet e profilit te metalit etj. qe do te thotë se specifikimi teknik ka mangësi të shumta.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e ekspertit shqyrtues dhe në bazë të shkresave të lëndës, vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë është bërë në harmoni me nenin 62 të LPP-së për faktin se ka shumë mangësi dhe pa qartësi për shumë artikuj ashtu siç u ceken edhe më lartë dhe njëherit AK nuk ka specifikuar shume kërkesa të domosdoshme që lidhen me artikujt.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Policia e Kosovës";

1x1 OE "Graniti"SH.P.K,-Istog;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.